



Stadt Chur

Deutsch für die Schule

**Ta mësojmë gjermanishten në vitin para
hyrjes në kopshtin e fëmijëve**

Informata për prindër

Tek hyrja në kopshtin e fëmijëve në moshën 5-vjeçare, një fëmijë duhet të jetë i aftë të komunikojë në gjermanisht. Nëse një fëmijë nga Chur nuk posedon aftësi të mjaftueshme në gjermanisht, atëherë ai e ndjek programin e nxitjes së hershme të gjuhës. Në vitin para hyrjes në kopshtin e fëmijëve, fëmijët në dy gjysmë ditësh në javë shoqërohen në kujdestari fëmijësh në një ofertë gjermanishtfolëse bashkë me fëmijët gjermanishtfolës. Prindërit marrin pjesë në një program arsimor për prindër dhe e përkrahin në mënyrë aktive fëmijën e tyre gjatë vitit të nxitjes. Çfarë do të thotë kjo për fëmijët, si duhet të veprojnë prindërit gjatë kësaj dhe çfarë kostosh shkaktohen? Një mbikëqyrje.

Pse ta mësojmë gjermanishten tashme para hyrjes në kopshtin e fëmijëve? *Drejtësia e shanseve*

Njohuritë e gjermanishtes janë të domosdoshme për suksesin në shkollë. Fëmijët, të cilët në fillim të ndjekjes së kopshtit të fëmijëve e flasin gjermanishten vetëm shumë pak ose aspak, fillojnë karrierën e tyre shkollore me parakushte më të këqija sesa shokët dhe shoqet e tyre gjermanishtfolës/e. Duhet disa vite, derisa fëmijët e zotërojnë gjuhën e mjedisit, pra gjermanishten. Prandaj është e rëndësishme, që atyre tashme para hyrjes në kopshtin e fëmijëve t'u mundësohet mësimi i gjermanishtes.

Mosha më e rëndësishme për mësimin dhe zhvillimin e gjuhës është mosha parashkollore. Hyrja në kopshtin e fëmijëve në Chur bëhet në moshën pesë vjeçare.

Prandaj në ligjin shkollor të Churit (711, neni 39) u krijua mundësia, që fëmijët në moshën parashkollore me pak ose aspak njohuri në gjermanisht mund të marrin nxitje në programin "Deutsch für die Schule" dhe gjithashtu që pjesëmarrja për prindërit dhe fëmijët e tyre të deklarohet si e obligueshme.

Si mësojnë fëmijët e vegjël gjermanishten? *Duke lozur, nga fëmija në fëmijë*

Fëmijët e vegjël mësojnë, kur ndihen rehat. Ata mësojnë gjuhët përmes një mjedisi nxitës, kontaktit me persona të afërt në situata të përditshme dhe me bashkëmoshatarë. Profesionistët tanë në grupe lojërash (Spielgruppen), në çerdhe (Kinderkrippen), në familje ditore (Tagesfamilien) dhe në kopshtin e fëmijëve "Montessori" (Montessori Kindergarten) kanë një arsimim special dhe e nxitin zhvillimin e gjuhës në mënyrën e qëllimshme dhe duke lozur (shihni listën e ofruesve).

Për ndjekjen e një oferte të tillë ekzistojnë shumë arsye të tjera përveç nxitjes së gjermanishtes. Në këto institucione, fëmijët lozin së bashku, integrohen në një grup, zhvillojnë personalitetin e tyre dhe bëhen më të pavarur. Vihet theksi në një nxitje të gjithanshme të fëmijëve.

Si mund të konstatohet, nëse fëmija im flet mjaft gjermanisht?

Specialistë të Universitetit Bern kanë zhvilluar një pyetësor në një procedurë shkencore. Me anë të këtij, prindërit mund t'i vlerësojnë njohuritë e gjermanishtes së fëmijës të tyre saktësisht, edhe nëse vetë nuk flasin gjermanisht. Pyetësori ekziston në shumë gjuhë. Në janar u dërgohet me postë këtyre familjeve prej një prapaskene me gjuhë të huaja, fëmijët e të cilave janë një vit e gjysmë para hyrjes në kopshtin e fëmijëve.

Prindërit duhet ta plotësojnë pyetësorin sipas së vërtetës dhe duhet ta kthejnë me postë.

Në mars, prindërit informohen me shkrim nga Shërbimet Sociale Chur për rezultatin dhe hapat e mëtejshme. Nëse nga vlerësimi del, që njohuritë e gjermanishtes të një fëmije nuk mjaftojnë në lidhje me hyrjen në kopshtin e fëmijëve, prindërit marrin një regjistrim të obligueshëm për pjesëmarrjen në programin „Deutsch für die Schule“. Nëse prindërit e refuzojnë regjistrimin, ata mund të parashtrajnë një deklaratë me shkrim tek Shërbimet Sociale. Mos-pjesëmarrja mund të pasohet sipas Kodit Penal neni 292 nga një gjobë.

Një regjistrim - dhe tani? *Konfirmimi i vendit*

Bashkë me regjistrimin në programin "Deutsch für die Schule" prindërit marrin listën e ofruesve me grupet e lojërave, çerdhet, familjet ditore dhe me kopshtin e hershëm të fëmijëve, prej të cilave mund të zgjedhin. Prindërit hyjnë në kontakt me një ofertë, shkojnë atje "për të nuhatur" dhe prenotojnë një vend. Udhëheqja e programit „Deutsch für die Schule“ i përkrah prindërit në sigurimin e vendeve.

Nëse prindërit kanë gjetur një vend, ata bashkërisht me drejtorinë e ofertës e plotësojnë konfirmimin e vendit. Drejtoria ia dërgon konfirmimin udhëheqjes së programit.

Sa shpesh fëmija im duhet të marrë pjesë? 2 herë 3 deri 4 orë në javë në vitin para hyrjes në kopshtin e fëmijëve

Programi i obligon fëmijët ta mësojnë gjermanishten në dy gjysmë ditësh në javë në vitin para hyrjes në kopshtin e fëmijëve. Një gjysmë dite në një grup lojërash normalisht zgjat të paktën tri orë. Ndjekja e rregullt është e obligueshme. Grupet e lojërave orientohen sipas pushimeve shkollore të Komunës Chur. Nëpër çerdhe, viti i

programit normalisht fillon më 1 gusht dhe përfundon më 30 qershor. Prindërit bien dakord, që ofruesit e njoftojnë udhëheqjen e programit, nëse fëmija nuk merr pjesë rregullisht ose nëse tarifat nuk paguhen.

Sa paguajnë prindërit? *Mbështetja financiare*

Nëse fëmija im merr pjesë në program, atëherë Komuna Chur kontribuon në shpenzimet e kujdestarisë në formë uljesh tarifash. Këto janë në nivele të ndryshme sipas të ardhurave të tatueshme si dhe sipas pasurisë dhe shkojnë nga 20 deri në 80% të tarifave përkatëse.

Orët shtesë ose gjysmë ditësh shtesë paguhen nga vetë prindërit.

Çfarë do të thotë arsimimi i prindërve? *Të forcohen prindërit*

Prindërit, fëmijët e të cilëve marrin pjesë në programin „Deutsch für die Schule“, e obligojnë veten të marrin pjesë në tetë ngjarje prindërisht gjatë vitit të programit. Këto ngjarje i aftësojnë prindërit, t'i përkrahin fëmijët e tyre në mësimin e gjuhës; atyre u japin informacione rreth sistemit shkollor dhe rreth temave të tjera të dobishme. Oferta arsimore për prindërit organizohet kështu, që edhe prindërit në punë dhe prindërit pa njohuri të gjermanishtes të mund të marrin pjesë. Oferta arsimore për prindërit është falas.

Këta prindër, që kohën e tyre të obligueshme shkollore në shumicën e kohës e kanë kryer në një shkollë gjermanishtfolëse, marrin pjesë në dy ngjarje.

Udhëheqja e programit „Deutsch für die Schule“:

Bettina Joos Lopez

Kornplatz 12

7000 Chur

Telefoni

081 254 46 24

E-Mail

deutschfuerdieschule@chur.ch

Adresa postare:

Deutsch für die Schule, Kornplatz 12, Postfach 810, 7001 Chur

www.chur.ch